

**AKTI I THEMELIMIT
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Zais Shpk”**

Unë, Fatjon Ismaili, i biri I Zaimit dhe Merites, i datelindjes 28/04/1993, banues ne **Kavaje, shtetas shqiptar** i identifikuar me **ID. J30428094G** , që në vijim do te quhet **“Ortak”**;

Sot me date **14/08/2024**, vendosa te themeloj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar **“Zais Shpk”** ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1.Objekti i shoqerise

1.1.Shoqeria ka kete objekt veprimtarie;

Blerje-shitje materialesh ndertimi , Akomodime , Blerje-shitje pasurie te paluajtshme , Import-eksport .

1.2. Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj.

Neni 2.Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise

2.1. Ortaku i vetem vendosi qe shoqerine ta emertoje :

“Zais Shpk”

2.2. Selia e Shoqerise ndodhet ne : Tirane,Kavaje,Golem Autostrada Golem-Plepa , ndertese 1 kateshe, numer pasurie 10/216, vol.34, fq.173 .

2.3. Shoqeria mund te krijojte qendra sekondare , filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni.3. Regjimi Juridik

3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Stautit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi

3.2. Me vendim te tij Ortaku i vetem mund te ndryshoje regjimin juridik te Shoqerise, nese ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar.

Ne kete rast Ortaku do te pershtase Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te beje regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me ligjin

3.4. Shoqeria do te kete vulen e saj

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut

- 4.1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj .
- 4.2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.
- 4.3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortake ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.
- 4.4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
- 4.5. Ortaku ka te drejte te marre te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj
- 4.6. Ortaku ka te drejte te beje propozime, si dhe emeruje e shkarkoje, administratorin ose administratoret, punonjesit, ekspertin kontabel, apo likujdatoret

Neni 5

Kohezgjatja

- 5.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te papercaktuar.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

- 6.1. Kapitali themeltar eshte **100.000** (njqind mije) leke.
- 6.2. Z. Fatjon Ismaili ne cilesine e ortakut te vetem do te posedoje 1 kuote ,100% me vlere 100.000 leke.

Kreu IV
ORGANET E SHOQERISE

Neni 7

7.1. Vendimet ne Shoqeri merren nga Ortaku i Vetem ne Asamblene e Pergjithshme. Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise. Administratori i Shoqerise dhe ekspeti kontabel i autorizuar caktohen nga Ortaku i Vetem i shoqerise.

Kreu V
ADMINISTRIMI

Neni 8

8.1. Administrimi i shoqerise do te behet nga **Administratori** i saj.

Z. Fatjon Ismaili, titullar i kartes se identitetit me numer personal **J30428094G**.

8.2. Kohezgjatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 (pese) vjet me te drejte riperteritje ne perfundim te mandatit.

Kreu VI
DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

9.1. Fitimi I realizuar nga Shoqeria, mbas shlyerjes se detyrimeve ligjore do t'i mbetet Ortakut te shoqerise ne raportet e zoterimit te kuotave te kapitalit.

9.2. Ky akt shtypet dhe firmoset ne kater kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise

ORTAKU I SHOQERISE "Zais Shpk" SHPK
Fatjon Ismaili

